



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QËNDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”  
Shërbimi i Kardiologjisë

**SHPLLJE KËRKESË PËR DONACION**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e ndihmës në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të hospitalizuar në QSUNT.

Shërbimi i Kardiologjisë pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" kërkon instalimin e paketës së avancuar ekokardiografike Speckle Tracking Echocardiography (Strain Imaging) në dy aparaturat ekzistuese GE Vivid T8.

Vlerësimi i deformimit miokardial përmes Global Longitudinal Strain (GLS) përbën aktualisht një standard të rëndësishëm në diagnostikimin dhe monitorimin e shumë patologjive kardiovaskulare.

Instalimi i këtij moduli do të mundësojë:

- Diagnostikimin më të hershëm dhe më të saktë të pacientëve me kardiomiopati.
- Përmirësimin e vlerësimit të funksionit diastolik dhe identifikimin e pacientëve me insuficiencë kardiake me fraksion ejeksioni të ruajtur (HFpEF).
- Diagnostikimin e amiloidozës kardiake dhe sëmundjeve të tjera infiltrative.
- Vlerësimin më të avancuar të patologjive strukturore të zemrës.
- Përmirësimin e cilësisë së diagnostikimit dhe vendimarrjes terapeutike.

Duke qenë se aparaturat GE Vivid T8 janë tashmë funksionale, kërkohet vetëm instalimi dhe aktivizimi i paketës software për analizën e strain-it.